




Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës
Republika Kosova- Opstine Suvareka
Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka




Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Nr-DATË/A:	07Nr. <u>87</u> /350-4989 datë 06.03.2020
REFERENC-Ë:	07Nr. 350-4989 datë 20.01.2020
PËR/TO:	Shkelzen Kuqi- Suharekë
KOPJ/COPY:	Drejtorisë së Inspeksionit Arkivit të Drejtorisë Arkivit të Komunës
NGA/FROM:	Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
	DREJTORI: Sanie KUQI PUNOI:inxhi.dip.ark. Nexhmije Loshi Durmishi
LËNDA/SUBJECT:	AKTVENDIM MBI LEJËN NDËRTIMORE


Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim, ka pranuar kërkesën 07Nr. 350-4989 datë 20.01.2020 nga Shkelzen Kuqi nga Suhareka për Leje ndërtimi për objektin me destinim banim dhe afarizëm në ngastrat kadastrale 02039-6, me numër referues 11-463-284-2020, datë 16.01.2020, Zona Kadastrale Suharekë, pronë e **Shkelzen Kuqit**, andaj ky organ pas shqyrtimit të bërë ka vendosur si në dokumentin e bashkangjitur kësaj Shkrese.

• **AKTVENDIM MBI LEJEN NDERTIMORE**





Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës
Republika Kosova- Opstine Suvareka
Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka



Data: 06.03.2020

Numri i vrojtimit i lejes:

07Nr.87/350-4989

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim

Në bazë të Ligjit për Ndërtim, Nr. 04/L-110, nenet 14, 15, 19, 20 dhe 21, Udhëzimit Administrativ Nr.08/2017 për Normat Teknike të Planifikimit Hapësinor, Ligjit për Procedurën Administrative Nr.05/L-031, Rregullores mbi Rregullat dhe Procedurat për Ndërtimin e Objekteve 01-Nr-16-423, datë 26.01.2011, Rregullore për tarifa nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale 01Nr-16-9367, datë 31.12.2014; neni 2, pika 2.1 dhe 2.2 si dhe sipas Planit Zhvillimor Urban 01Nr.5820 datë 05.03.2008, kërkesës dhe dokumenteve të paraqitura nga **Shkelzen Kuqi** nga Suhareka, Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim lëshon këtë:

LEJE NDËRTIMORE

Kjo leje ndërtimore i lëshohet:			
Emri:	SHKELZEN KUQI	Nr. Personal:	
Adresa:	Rr. "Jetë Balia" Suharekë	Telefoni:	
Email :		Kërkesa Bazë:	Aplikim për Leje Ndërtimore 07Nr. 350-4989 datë 20.01.2020

Emri i Projektit:	OBJEKT AFARISTO-BANESOR		
Emri i Projektuesit:	"GEOLIMIT SH.P.K.", Suharekë		
Adresa:	Rruga "Brigada 123", Suharekë		
Telefoni:		Emaili:	

Për punët ndërtimore në vijim: NDËRTIM I RI		
Adresa: rruga "Jetë Balia" në Suharekë		
Zona(t) Kadastrale: Suharekë	Nr. i parcelës kadastrale:	GPS Koordinatat e objektit:
Certifikatës me nr. Referues: 11-463-284-2020 datë 16.01.2020 pronë e Shkelzen Kuqit.	02039-6	Y= 7485485.647; X=4690840.086 Y= 7485479.698; X=4690839.930 Y= 7485479.289; X=4690855.508 Y= 7485485.238; X=4690855.664

Lloji i ndërtimit të propozuar:

Objekt Afaristo-banesor

Kategoria e ndërtimeve të propozuara:

Kategoria II

Sipërfaqja e përgjithshme Bruto:850.49 m²

Gabariti	5.95m'x15.60m' Sipas Njoftimit publik dhe Kushteve ndërtimore	Katshmëria	B+P+4
Vija rregullative	Nga aksi i rrugës për qasje 4.0&6.2m' Nga kufiri kadastral nga lumi: 0.75&2.5m'	Vija ndërtimore	Nga vija rregulluse nga rruga për qasje 9.5&14.0m' Nga kufiri kadastral nga lumi: 7.0&5.3m'

Përshkrimi:

Lokacioni i objektit është në kuadër të PZhU 01Nr.5820 datë 05.03.08, ku sipas gjendjes së planifikuar parcela kadastrale është me destinim tokë ndërtimore-Zona Qendrore Banimore, andaj objekti në fjalë do të shfrytëzohet për banim dhe afarizëm, sipas projektit të hartuar nga ndërmarrja projektuese SHPK "Geolimit" Suharekë.

Objektet do të kenë karakter të përhershëm, me etazhitet B+P+4. Ndërtimi i objektit të bëhet konform kushteve të caktuara nga ky organ 07Nr.629/350-47268 datë 01.11.2019 dhe njoftimit publik 07Nr.582/350-47268 date 16.10.2019.

Objekti është i lejuar të ndërtohet 45% nga sipërfaqja bruto e parcelës (duke përfshirë në këtë sipërfaqe edhe objektin ekzistues), me gabarit në përdheshë: 5.95m'x15.60m'.

Kjo leje ndërtimore lëshohet në bazë të aplikacionit dhe informatave mbështetëse. Ndërtimi do të bëhet në përputhje me dokumentet e aprovuara ndërtimore. Çfarëdo ndryshimi i projektit duhet të aprovohet nga hartuesi i projektit dhe nga ky organ.

Poseduesi i Lejës Ndërtimore është i obliguar që:

- Puna në ndërtim duhet të fillojë brenda një (1) viti nga data e dhënies së kësaj leje ndërtimore, përveç nëse zgjatet afati i vlefshmërisë së saj në pajtim me Ligjin.
- Të vendos tabelën informuese në vendndërtim me informata e mëposhtme:
 - Informata mbi Lejën Ndërtimore;
 - Informata mbi Projektuesin;
 - Informata mbi Kontraktuesin;
 - Prezantimi grafik i dukjes së ndërtimit.
- Duhet të siguroheni se kontraktuesi në vendndërtim i posedon dokumentet e mëposhtme:
 - Një kopje të kësaj leje ndërtimore;
 - Nëse punët ndërtimore kryhen nga një palë e tretë, një kopje e kontratës ndërmjet poseduesit të lejes ndërtimore dhe kontraktuesit;
 - Një kopje e të gjitha dokumenteve të ndërtimit që janë nënshkruar ose vulosur si të



“APROVUAR” nga organi kompetent;

- Projektin Kryesor me të gjitha fazat për nevoja të realizimit të ndërtimit;
- Dokumentacioni që tregon konformitetin e produkteve të ndërtimit dhe pajisjeve me kërkesat rregullative, Kodin dhe me dokumentet e aprovuara të ndërtimit;
- Librin dhe ditarin e ndërtimit, që duhet të përmbajnë regjistër të hollësishëm ditor të të gjitha punëve ndërtimore, përfshirë të dhëna të shkruara dhe skematike, që dokumentojnë: datën, vendin dhe rezultatet e testeve të kryera në materialet ose punët ndërtimore; përshkrim të problemeve të hasura gjatë ndërtimit dhe inspektimit dhe mënyrën se si janë zgjidhur;
- Protokolet e miratuara të nevojshme për aplikim për çertifikatë të përdorimit’
- Të dorëzojë njoftim inspektoratit të Organit Kompetent për fillimin e ndërtimit së paku shtatë (7) ditë para fillimit të punëve ndërtimore;
- Të njoftojë organin kompetent për të kryer inspektimet siç kërkohet me ligj dhe akte nënligjore. Këto inspektime nuk e lirojnë aplikuesin për leje ndërtimore dhe/ose arkitektin ose inxhinierin e licencuar përgjegjës për sigurimin e inspektimeve adekuata dhe mbikëqyrje ditore të punëve ndërtimore.
- Të njoftojë organin kompetent për ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga Projektuesi. Poseduesi i Lejës Ndërtimore duhet të njoftojë organin kompetent për të gjitha ndryshimet në dokumentacionin ndërtimor të miratuar nga projektuesi përveq në rastet kur:
 - O Ndryshimet nuk janë në kundërshtim me Kushtet Ndërtimore, Kodin dhe rregulloret në fuqi;
 - O Ndryshimet në dimensionet e pjesëve të jashtme të ndërtimit nuk tejkalojnë 2% dhe zero presje një(0.1) metër por që nuk tejkalojnë vijën ndërtimore;
 - O Ndryshimet në organizimin e brendshëm janë në harmoni me Kushtet Ndërtimore, kodet dhe rregulloret teknike në fuqi;
- Nëse gjatë punimeve haset në elemente arkeologjike, Investitori është i obliguar ti ndërpresë punimet dhe të njoftoj organet komunale.
- Obligohet investitori që gjatë gërmimit dhe ndërtimit të objektit të bëjë pastrimin e materialit të panevojshëm për punë dhe se të njëjtin ta transportoj në deponinë për trajtimin dhe deponimin e mbeturinave nga ndërtimi dhe demolimi i objekteve ndërtimore me udhëzime të inspektoratit komunal.
- Pas përfundimit të punëve ndërtimore, duhet të aplikoni për çertifikatë të përdorimit në pajtim me ligjin, aktet nënligjore.

A r s y e t i m

Shkelzen Kuqi nga Suhareka me kërkesën 07Nr. 350-4989 datë 20.01.2020 ka kërkuar nga organi kompetent lëshimin e Lejës Ndërtimore për ndërtim të objektit me destinim banim dhe afarizëm, sipas projektit të bashkangjitur.

Kjo leje ndërtimore bazohet në shqyrtimin e provave:

- Aktvendimi mbi Kushtet Ndërtimore 07Nr.629/350-47268 datë 01.11.2019 (kopje)
- Njoftimit publik 07Nr.582/350-47268 date 16.10.2019.
- Dëshmi për pagesën e taksës sipas njoftimit 07Nr.15/350-4989 datë 21.01.2020, në shumë prej: 3 068.68 € e paguar në I.F.J.B. Vllesa-Co Therandë, me datë: 02.03.2020, sipas faturës komunale nr.0000491, datë: 19.02.2020.

- Ky organ përmes shërbimit të vetë profesional pas shqyrtimit të kërkesës dhe dokumenteve tjera përcjellëse si dhe konform PZhU 01Nr.5820 datë 05.03.08 dhe Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për ndërtimin e objekteve 01Nr.16-423 datë 26.01.11, ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet e nevojshme dhe se investitorit mund ti jepet Leja ndërtimore andaj u vendos si në dispozitiv.

Drejtoria për Urbanizëm dhe Planifikim
Numri i vrotimit i lejes, 07Nr.87/350-4989 të datës 06.03.2020, Suharekë

Drejtor i Drejtorisë
Sanje KUQI
Domick